

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 59/25) dhe nenit 5 paragrafi 1 nga Rregullore për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve nr.01-440/3 datë 28.12.2022, nr. 01-176/3 datë 1.3.2023 nr. 01-197/3 datë 15.4.2024, nr. 01-109/3 datë 11.2.2025 dhe nr. 01-157/4 të datës 25.3.2025, dhe Koncepti për maturë shtetërore, maturë shkollore dhe provimin përfundimtar në arsimin e mesëm publik nga viti 2025, Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall

KONKURS PUBLIK

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore dhe përkthyes dhe lexues të pavarur të materialit të provimit për nevojat e maturës shtetërore

I. Qendra Shtetërore e Provimeve shpall konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore dhe përkthyes dhe lexues të pavarur të materialit të provimit për nevojat e maturës shtetërore

Bashkëpunëtorët e jashtëm po angazhohen në rolin e:

a) kryetarë dhe anëtarë të komisioneve shtetërore të maturës për lëndët:

- 1) Gjuhë Serbe – 1 (një) kryetar dhe 2 (dy) anëtarë dhe
- 2) Gjuhë Italiane – 1 (një) kryetar dhe 2 (dy) anëtarë

b) përkthyes të materialit të provimit të maturës shtetërore për lëndët:

- 1) Matematikë – 1 (një) për përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe dhe anasjelltas;
- 2) Matematikë – 1 (një) për përkthim gjuha maqedonase në gjuhën turke dhe anasjelltas;
- 3) Estetikë – 1 (një) për përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe dhe anasjelltas;
- 4) Gjuha maqedonase në gjuhën turke dhe anasjelltas - 1 (një) përkthyes dhe
- 5) Gjuha maqedonase në gjuhën shqipe dhe anasjelltas - 1 (një) përkthyes

c) lexues të pavarur të materialit të provimit të maturës shtetërore për lëndët:

- 1) Gjuhë Maqedonase dhe Letërsi - 1 (një) lexues i pavarur;
- 2) Gjuhë Shqipe dhe Letërsi – 1 (një) lexues i pavarur;
- 3) Gjuhë Turke dhe Letërsi – 1 (një) lexues i pavarur;
- 4) Gjuha Serbe dhe Letërsi – 1 (një) lexues i pavarur;
- 5) Gjuhë Angleze – 1 (një) lexues i pavarur;
- 6) Gjuhë Frënge – 1 (një) lexues i pavarur;
- 7) Gjuhë Gjermane – 1 (një) lexues i pavarur;
- 8) Gjuhë Ruse – 1 (një) lexues i pavarur;
- 9) Gjuhë Italiane – 1 (një) lexues i pavarur;
- 10) Matematikë – 1 (një) lexues i pavarur;
- 11) Filozofi – 1 (një) lexues i pavarur dhe
- 12) Estetikë – 1 (një) lexues i pavarur.

II. Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët që konkurrojnë për konkursin publik dhe dokumentacioni i detyrueshëm që duhet të dorëzojnë.

a) Kushtet e nevojshme për kryetarët dhe anëtarët e komisioneve lëndore të maturës shtetërore dhe dokumentacioni i detyrueshëm që duhet të dorëzojnë:

a.1) Kandidatët që konkurrojnë për kryetarë të komisionit lëndor të maturës shtetërore duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ketë përfunduar të paktën studime akademike të ciklit të dytë në fushën përkatëse;
- të jenë nga radhët e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional nga universitetet në RMV në lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse;
- të kenë të paktë 5 (pesë) vjet përvojë pune në veprimtari arsimore ose shkencore dhe
- të kenë punime të botuara profesionale, përkatësisht shkencore që janë në funksion të fushës përkatëse.

Kandidatët që konkurrojnë për kryetarë të komisionit lëndor të maturës shtetërore duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- formularin e aplikimit të plotësuar (formulari i aplikimit është i vendosur në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- biografi e shkurtër;
- certifikatën e shtetësisë;
- një kopje të certifikatës/diplomës për studime të përfunduara akademike të ciklit të dytë në fushën përkatëse, e vërtetuar në noter;
- vërtetim për marrëdhënien e rregullt të punës së si pjesë e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional të universiteteve në Republikën e Maqedonisë në lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse;
- vërtetim për të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në veprimtari arsimore ose shkencore dhe
- kopje të faqes së parë të punimeve të botuara profesionale ose shkencore që janë në funksion të fushës përkatëse.

a.2) Kandidatët që konkurrojnë për anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore, duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të përfunduar të paktën studime akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse;
- të jenë nga radhët e individëve profesional-mësimdhënës të lëndës përkatëse në shkollat e mesme në RMV, por nëse nuk ka mësimdhënës të tillë të paraqitur, do të merren parasysh edhe mësimdhënësit e lëndës përkatëse në shkollat fillore në RMV;
- të kenë të paktën 7 (shtatë) vjet përvojë në mësimdhënie dhe
- të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë në procesin e vlerësimit të provimeve eksterne të maturës shtetërore. Si përjashtim, nëse nuk konkurrojnë mjaft kandidatë, personat me më pak ose aspak përvojë do të merren parasysh në procesin e vlerësimit.

Kandidatët që konkurrojnë për anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- formularin e aplikimit të plotësuar (formulari i aplikimit është i vendosur në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- biografi e shkurtër;
- certifikatën e shtetësisë;
- një kopje të certifikatës/diplomës për studime të kryera akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse, e vërtetuar në noter;
- vërtetim se janë nga radhët e individëve profesional-mësimdhënës të lëndës përkatëse në shkollat e mesme ose fillore në RMV;

- vërtetim për të paktën 7 (shtatë) viteve përvojë në mësimdhënie dhe
- provë për të paktën 3 (tre) vjet përvojë në procesin e vlerësimit të provimeve eksterne të maturës shtetërore (aktvendim, kontratë ose vërtetim) në qoftë se ka.

Kryetarët dhe anëtarët duhet të kenë përvojë në përgatitjen e materialit të provimit.

b) Kushtet e nevojshme për përkthyes të materialit të provimit të maturës shtetërore dhe dokumentacioni i detyrueshëm që duhet të dorëzohet:

Kandidatët që konkurrojnë për përkthyes duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të përfunduar të paktën studime akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse;
- të jenë nga radhët e mësimdhënësve të lëndës përkatëse në shkollat e mesme në RMV ose nga radhët e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional nga universitetet në RMV për lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse;
- të kenë të paktën 3 vjet përvojë pune në mësimdhënie dhe
- të jenë njohës të shkëlqyer të gjuhës burimore (gjuhën nga e cila po përkthehet materiali) dhe gjuhën e synuar (gjuhën në të cilën po përkthehet materiali).

Kandidatët për përkthyes duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- formularin e aplikimit të plotësuar (formulari i aplikimit është i postuar në ueb faqen: www.dic.edu.mk);
- certifikatën e shtetësisë;
- kopjen e certifikatës/diplomës së arsimit të lartë përkatës dhe
- vërtetimin origjinal të punësimit të rregullt dhe përvojën e duhur të punës prej të paktën 3 vjet si mësimdhënës i lëndës përkatëse të lëshuar nga shkollat e mesme në RMV ose si pjesë e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional të universiteteve në RMV për lëndën përkatëse, gjegjësisht fushën përkatëse, të lëshuar nga universitetet në RMV.

c) Kualifikimet e kërkuara për lexues të pavarur të materialit të provimit të maturës shtetërore dhe dokumentacioni i detyrueshëm që duhet të dorëzohet:

Kandidatët që konkurrojnë për lexues të pavarur duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ketë përfunduar të paktën studime akademike të ciklit të dytë në fushën përkatëse;
- të jetë nga radhët e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional nga universitetet në RMV në lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse;
- të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune në veprimtari arsimore ose shkencore;
- të ketë punime të botuara profesionale, ose shkencore që kanë lidhje me fushën përkatëse.

Kandidatët për lexues të pavarur duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- formularin e aplikimit të plotësuar (formulari i aplikimit është i postuar në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- certifikatën e shtetësisë;
- një kopje të certifikatës/diplomës së arsimit të lartë përkatës;
- një kopje të certifikatës/diplomës së arsimit të ciklit të dytë në fushën përkatëse;
- vërtetim origjinal i marrëdhënies së rregullt të punës si pjesë e kuadrit mësimor-shkencor ose profesional të universiteteve në RMV në lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse dhe përvojën e duhur të punës së paku 5 vjet në veprimtari arsimore ose shkencore;
- një kopje të faqes së parë të punimeve të botuara profesionale, përkatësisht shkencore që kanë lidhje me fushën përkatëse.

III. Qendra Shtetërore e Provimit do të kryejë një përzgjedhje sipas kritereve të mësipërme, kurse me kandidatët që plotësojnë kërkesat e specifikuar në konkurs do të zhvillohet intervistë, përveç kandidatëve për përkthyes të materialeve të provimit ku para intervistës së pari do të bëhet verifikimi i kandidatëve në lidhje me

njohjen e gjuhës burimore (gjuhës nga e cila po përkthehet materiali) dhe gjuhës së synuar (gjuhës në të cilën po përkthehet materiali), dhe vetëm kandidatët të cilët do të kalojnë verifikimin e njohjes së gjuhës do të thirren në intervistë, e më pas do të pasojë përzgjedhja përfundimtare.

IV. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm - kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore dhe përkthyesve dhe lexuesve të pavarur të materialit të provimit të maturës shtetërore bëhet në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

V. Kandidatët që do të zgjidhen kryetarë dhe anëtarë të komisioneve të lëndore të maturës shtetërore do të angazhohen **deri në fund të vitit shkollor 2024/2025**, ndërsa kandidatët që do të zgjidhen përkthyes dhe lexues të pavarur të materialit të provimit të maturës shtetërore do të angazhohen **deri në fund të vitit shkollor 2025/2026**.

VI. Afati për aplikim të kandidatëve të interesuar është **7 (shtatë) ditë**.

VII. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të kryhet jo më vonë se 18 (tetëmbëdhjetë) ditë pas përfundimit të afatit të aplikimit.

VIII. Dokumentacioni i dërguar jashtë afatit, i paplotë dhe i pavlefshëm, nuk do të merret parasysh.

IX. Aplikimet me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në ora 14:00) ose me postë rekomanduese, në adresën: *Qendra Shtetërore e Provimeve - Shkup rr. "Vasil Gjorgov" p.n. 1000 Shkup*, me shënimin "**Për konkursin publik për bashkëpunëtorë të jashtëm - ...**" (specifikohet se për çfarë aplikon dhe për çfarë lënde aplikon).

X. Informacione shtesë mund të merren në numrin 075/284-335 (për kryetarë dhe anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore) dhe 076/484-739 (për përkthyes dhe lexues të pavarur të materialit të provimit të maturës shtetërore), çdo ditë pune nga ora 10:00-14:00.

QENDRA SHETËRORE E PROVIMEVE SHKUP